



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 144505/8870/446 Regjistri Themeltar

Nr. 406(86-2020-498)Vendi mi

Datë 24.05.2017 regjistrimi

Datë 24.02.2020

V E N D I M  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

**KRYESUESE :** Altina NASUFI

**ANËTAR:** Arjan QAFA

**ANËTARE:** Fjoralba PRIFTI

-asistuar nga sekretare gjyqësore [REDACTED], në Tiranë në datë 24.02.2020 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me palë ndërgjyqëse:

**PADITËS:**

[REDACTED] e bija e [REDACTED] e datëlindjes [REDACTED], lindur në [REDACTED] dhe banuese në [REDACTED].

**I PADITUR:**

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

**OBJEKTI:**

Shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 132, datë 15.09.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Njohjen nga gjykata të diskriminimit tim për largimin nga puna.

24/10/2018

**BAZA LIGJORE:**

Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar; Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 877 (887), datë 07.03.2017 ka vendosur:**

- Pranimin e pjeshëm të padisë.
- Shfuqizimin e aktit administrativ në trajtën e vendimit nr. 132, datë 15.09.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Detyrimin e palës së paditur Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të rimarrë në shqyrtim kërkesën ankimore të paditëses [REDAKTUAR] dhe të kryejë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes objekt procedimi administrativ.
- Rrëzimin e padisë për sa i përket pjesës tjetër të kërimit si të pabazuara në ligj.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe në çastin kur merr formë të prerë ekzekutohet në mënyrë të drejtëprejtë nga Zyrat e Përmbarimit në Republikën e Shqipërisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit që për palët në mungesë fillon nga dita e marrjes dijeni.

**Kundër këtij vendimi në datë 21.03.2017 ka paraqitur ankim paditësja [REDAKTUAR] duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të kërkesëpadisë:**

- Paditësja [REDAKTUAR] pas largimit nga puna me datë 05.10.2015 i është drejtuar me ankesë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me largimin nga puna. Me datë 13.01.2016 është thirrur nga Komisioneri ku është mbajtur një seancë dëgjimore. Në këtë seancë dëgjimore ajo ka paraqitur të gjitha provat dhe faktet në lidhje me diskriminimin e saj për largimin nga puna. Gjatë kësaj seance dëgjimore Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk e ka trajtuar çështjen diskriminuese të bordit të prindërve që është bërë ndaj saj, përmes letër informimit të datës 03.09.2015. Në datë 15.09.2016 paditësja është vënë në dijeni të vendimit nr. 132, datë 15.09.2016 të

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky vendim është marrë në shkelje flagrante të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e pikërisht të pikës 10, të nenit 33. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në vlerësimin e saj nuk e ka përmendur shkeljen e pikës 10 të nenit 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

- Gjithashtu Gjykata në vlerësimin e saj nuk është shprehur për pikën 2 të objektit të padisë duke shkelur nenin 37 e 38 të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte është shumë e qartë, që veprimet e të paditurit rezultojnë arbitrare, të kryera në kundërshtim flagrant me ligjin e si të tilla ato duhet të shfuqizohen.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar ka vendosur pranimin e ankimit.

**Kundër këtij vendimi në datë 07.04.2017 ka paraqitur ankim edhe pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e plotë të kërkesëpadisë:**

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka anashkaluar ligjin, nuk ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura në gjykim, nuk është shprehur përse ka kërkuar pala paditëse, ka cënuar standartin e arsytimit të vendimit gjyqësor, etj.
- Gjykata ka arsyetuar se Komisioneri nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes administrative. Komisioneri e kundërshton këtë arsyetim pasi ka bërë hetim të plotë dhe të gjithanshëm, duke marrë hapat e poshtëshënuara:
  1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. regj. 84, datë 13.10.2015 të znj. [REDAKTUAR], e cila pretendon se është diskriminuar për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”, nga Drejtuesja e Shkollës së arsimit 9-vjeçar “Ali Demi”, Tiranë. Në ankesë është parashtruar nga ankuesja Znj. [REDAKTUAR] se ajo, është diplomuar si mësuese e lëndës Histori-Gjeografi në vitin 1999, dhe ka një vjetërsi pune prej afro 10 vitesh në mësimdhënie, në arsimin e ciklit 9-vjeçar. Ajo është emëruar si mësuese e lëndës Histori-Gjeografi, në shkollën 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë, me kontratë punësimi, deri në zhvillimin e procedurave të

konkurrimit për vendin e lirë të punës. Gjatë muajit Mars 2015, nga Drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, u shpall konkursi për vend të lirë pune, për lëndën e Histori-Gjeografisë. Në fazën e depozitimit të dosjeve, u paraqitën dy konkurrente: ankuesja dhe znj.A [REDAKTUAR] Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë (DAR Tiranë), ka anuluar këtë procedurë konkurrimi, me arsyetimin se aplikantja tjetër, znj.A [REDAKTUAR] kishte mungesë dokumentacioni.

- Në zbatim të nenit 33, pika 5 dhe 7, të LMD, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa është njoftuar për paraqitjen e saj dhe i është kërkuar njëkohësisht informacion si Drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë dhe DAR Tiranë, lidhur me pretendimin e ngritur nga znj. [REDAKTUAR]. DAR Tiranë, ka informuar Komisionerin se: “...Zgjidhja e kontratës së punës së znj. [REDAKTUAR] është bërë për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2015-2016, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 44, datë 16.10.2014 të MAS. Pra, nga shpërndarja e ngarkesës mësimore të të gjithë stafit drejtues dhe personelit mësimor, duke ngarkuar fillimisht me ngarkesë mësimore personelin mësimor që kanë një emërim definitiv, ka rezultuar se për mësuesen, znj. [REDAKTUAR] (me kontratë të përkohshme) nuk ka më ngarkesë mësimore, pra suprimohet vendi i punës. Drejtoresha e shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë, dhe DAR Tiranë, informojnë se znj. [REDAKTUAR] i është zgjidhur kontrata e punës pasi, (duke qenë me kontratë të përkohshme, dhe e mbetur pa ngarkesë mësimore), vendi i saj i punës është suprimuar. Bashkëlidhur janë dërguar kopje të dy praktikave të mbajtura për dy shpalljet e bëra nga shkolla 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë, respektivisht, me datë 28.04.2015 dhe me datë 07.05.2015).
- Në zbatim të nenit 33, pika 8, të LMD, me datë 13.01.2016, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve. Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve. Ankuesja parashtrroi të njëjtat argumente si në ankesë, lidhur me pretendimin se vendi i saj nuk është suprimuar dhe se ngarkesa mësimore është e plotë dhe jo 8 orë në javë. Drejtorja e Shkollës iu përmbajt deklarimeve të sjella me shkresë se, vendi i znj. [REDAKTUAR] është suprimuar pasi nuk ka ngarkesë të plotë mësimore. Nga ana e Komisionerit iu kërkuar Drejtores së Shkollës të sillte dokumente provues lidhur me pretendimet e ankueses.
- Komisioneri konkludoi sa më poshtë: Lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar nga Drejtorja e shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, përmes anulimit të

procedurës së konkurimit dhe më pas të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, për shkak të gjendjes arsimore. Ankuesja ishte emëruar si mësuese e lëndës së histori-geografisë, me kohëzgjatje deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për vendin e lirë të punës. Ndërkohë që ankuesja ishte në marrëdhënie pune me këtë institucion, Drejtoria e kësaj shkolle me datë 16.04.2015, shpall njoftimin e kërkesave për lëvizje paralele, për vendin e lirë të punës në pozicionin e mësues historio-geografie. Për këtë pozicion pune ka paraqitur dokumentacionin znj.E.S. ardhur nga shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”. Rezultoi se, me shkresën me nr.18 prot., datë 28.04.2015, drejtoria e shkollës kishte anuluar procedurën për lëvizjen paralele, për shkak të mosparaqitjes së asnjë kërkesë për lëvizje paralele për pozicionin e mësuesit të profilit “Historio-geografi” dhe ka filluar procedurën e konkurimit për të gjithë kandidatët e interesuar këtë pozicion pune.

- Me datë 28.04.2015, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve, për pozicionin e shpallur. Nga arsyetimi i bërë nga ky Komision, kandidatja E.S nuk është shpallur fituese, pasi Komisioni vlerësoi se: Performanca e kësaj kandidate ishte shumë e ulët, (bazuar në mesataren e ulët 5.5 të studimeve të saj universitare) dhe mungonte vlerësimi i punës nga ana e drejtuesit të shkollës ku ajo punonte aktualisht.
- Në përfundim, Komisioni ka sugjeruar të mos vazhdohet procedura për këtë vend pune, deri në fillim të muajit shtator të vitit 2016, ku të rishihej ngarkesa mësimore. (Pasi duhej verifikuar rishtazi procedura e hapjes së këtij vendi të lirë pune, për arsye se norma mësimore për lëndën e histori-geografisë nuk ishte e plotë dhe duhej bazuar në planifikimin e vitit të ri shkollor 2015-2016, nëse kjo normë do ekzistonte, pasi nuk mund të bëheshin emërimet pa qenë të sigurtë për vendin e punës). Siç shihet, përmes Urdhërit nr.19, është krijuar një komision vlerësimi për një procedurë të anuluar më parë, për shkak të mosparaqitjes së asnjë kandidate.
- Me datë 07.05.2015, Drejtoria e kësaj shkolle, ka shpallur njoftimin për hapjen e procedurave të konkurimit, për vendin e lirë të punës në pozicionin historio-geografi, ku janë paraqitur dy kandidate: Znj.A.A. dhe Znj. (ankuesja). Është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve për vendin e shpallur. Komisioni pasi ka shqyrtuar dosjet e dy aplikanteve, ka anuluar procedurën e konkurimit për këto aplikante, pasi kandidatja A.A, ka patur mungesa në dokumentacion (dëshmia e penalitetit dhe deklarata se nuk ka masa disiplinore në fuqi). Znj. pretendon se nga ana e Drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, është manipuluar dosja

personale e znj.A.A, me qëllim favorizimin e saj. Mirëpo, nga komunikimi dhe dokumentimi shkresor i Drejtorisë së shkollës dhe DAR Tiranës, rezulton që fakti i mungesës së dokumentacionit të kërkuar, është i cituar si në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, pranë shkollës, po ashtu dhe në shkresën e kthimit të përgjigjes nga ana e DAR Tiranës aplikantes A.A.

- Referuar Udhëzimit nr. 35, datë 30.09.2014 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar”, shtojcës 2 dhe .4, të tij, rezulton se dëshmia e penalitetit dhe deklarata se aplikanti nuk ka masa disiplinore në fuqi, janë dokumente të detyrueshme për t’u paraqitur nga aplikantët dhe se mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm passjell s’kualifikimin e aplikantit. Pra, konkluzioni i Komisionit të Vlerësimit për mospranimin e aplikimit të znj.A.A është konform zbatimit të udhëzimit të MAS. Në përfundim të kësaj procedure, Komisioni pas shqyrtimit të dosjeve të dy aplikanteve, ka anuluar procedurën e konkurimit pasi njëra nga kandidatet ka patur mungesa në dokumentacion. Ankuesja ████████ është ankuar pranë DAR Tiranës, sipas parashikimeve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 35, datë 30.09.2014, pika 624 dhe ka marrë përgjigje se, në referim të Udhëzimit nr. 35, datë 30.09.2014: “...Duke qenë se nga 2 aplikime për mësuese të profilit “Histori-Gjeografi” në këtë shkollë vetëm 1 aplikim ka dokumentacionin e kërkuar dhe rrjedhimisht vetëm një aplikim është kualifikuar, procedura e konkurimit është anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës ndërmjet aplikantëve të kualifikuar”. Referuar këtij akti nënligjor, nuk është parashikuar në mënyrë specifike anulimi i procedurës së konkurimit për shkakun e pretenduar si nga DAR Tiranë dhe nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë. Ky qëndrim, ka qenë i disfavorshëm për ankuesen dhe i pambështetur në ligj, duke i mohuar asaj mundësinë për punësim për vendin e shpallur.
- Lidhja midis shkakut të pretenduar të diskriminimit dhe pasojave të disfavorshme që kanë ardhur për ankuesen. Neni 1, i LMD-së parashikon se “gjendja arsimore” është shkak i mbrojtur nga ky Ligj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, rezulton se të dy kandidatet si ankuesja ashtu edhe kandidatja tjetër znj. A.A, kishin arsim të lartë përkatës në lëndën e “histori-gjeografisë” dhe në përputhje me kërkesat e bëra në shpalljen e shkollës për vendin vakant të lëndës së histori-gjeografisë. Pra, pretendimi i ankueses se është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme

se kandidatja tjetër për shkak të gjendjes arsimore. nuk është i argumentuar dhe nuk qëndron, pasi të dyja kandidatet e përmbushin këtë kriter.

- Ankuesja pretendoi se shkak për diskriminimin e saj nga drejtoresha e shkollës është bërë edhe denoncimi që i ka bërë asaj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë. Në lidhje me këtë shkak të pretenduar diskriminimi, neni 1 i LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, ç'ka është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.
- Në lidhje me këtë shkak të pretenduar diskriminimi, rezultoi se, ankuesja, ka bërë kallëzim penal ndaj drejtoreshës së shkollës 9-vjeçare "Ali Demi", Tiranë, për kanosje serioze për jetën. Për këtë kallëzim, Prokuroria ka vendosur mosfillim të procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Nga konsultimi me dokumentacionin, Komisioneri konstaton se, kallëzimi penal i ankueses mban datën 05.10.2015, pra, mbas mbylljes së procedurave të shpallura për vendin vakant të lëndës së histori-geografisë, dhe pas vendimit të drejtoreshës së shkollës, më datë 10.09.2015 për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen. Pra, i gjithë konflikti i gjeneruar (mes ankueses dhe drejtueses së shkollës) ka ardhur pas komunikimit të bërë ankueses për përfundimin e marrëdhënies së punës me shkollën 9-vjeçare "Ali Demi" dhe nuk ka qenë shkak i fillimit të këtij konflikti, siç pretendon ankuesja.
- Ankuesja pretendoi gjithashtu se është paragjykuar nga ana e kolegeve të saj (dy nga të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit të vlerësimit të saj në procedurën e konkurimit për vendin e shpallur vakant) për shkak të veshjes së saj të thjeshtë e modeste. Kjo rrethanë për të cilën Gjykata është shprehur se duhej të verifikohet nga ana e KMD-se, rezultoi e pamundur për t'u provuar nga ana e KMD-së.
- Në përfundim të gjithë procedurës së ndjekur, Komisioneri konstatoi se, ka paligjshmëri nga ana e drejtorisë së shkollës, sa i takon procedurës së shpalljes së vendit vakant dhe vendimit të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, të cilët e kanë vendosur ankuesen në një pozicion të disfavorshëm. Por, për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare "Ali Demi", duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji "Për mbrojtjen

nga diskriminimi” dhe trajtimit të disfavorshëm të ankueses, gjë që gjatë trajtimit të ankesës nuk u provua.

- Me vendimin nr. 132, datë 15.09.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim vendosi: “Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “për çdo shkak tjetër”, të znj. [REDAKTUAR], nga ana e Drejtueses së Shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë.”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka bërë një hetim të gjithanshëm lidhur me ankesën e znj. [REDAKTUAR], bazuar në parashikimet e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe Kodit të Procedurave Administrative. Arsytimi i Gjykatës, se nga ana e Komisionerit nuk është kryer një hetim i plotë, është i pabazuar. Provat e paraqitura nga KMD-ja në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, vërtetojnë të kundërtën.
- Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, është marrë në shkelje të parimit të disponibilitetit të padisë. Në vendim Gjykata është shprehur përtej asaj që është kërkuar në objektin e padisë nga pala paditëse, duke tejkaluar kërkimet e subjektit në objektin e padisë. Gjykata nuk ka zbatuar parashikimet e nenit 6 të K. Pr. Civile ku gjen zbatim ky parim kryesor i procesit gjyqësor. Gjykata i ka kaluar kufijtë e padisë, sepse ajo është shprehur për gjëra që nuk i janë kërkuar, siç është vendimi i Gjykatës, për të rimarrë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, edhe një herë në shqyrtim e ankesës e znj. [REDAKTUAR] Gjithashtu është shkelur neni 28 i K. Pr. Civile”.
- Gjykata ka vendosur që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të rimarrë në shqyrtim çështjen.
- Së pari, theksojmë se kjo bie në kundërshtim me parashikimet e Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Pra, KMD-ja nuk mund të shqyrtojë një çështje për të cilën ka marrë vendim.
- Së dyti, zgjidhja e çështjes në themel është detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Vendimet e Komisionerit, janë akte administrative, të cilat kundërshtohen në gjykatë, e cila ka detyrimin të vendosë përfundimisht mbi çështjen (pika 27 e vendimit nr.35, datë 27.06.2016 të GJK).
- Lidhur me qëndrimin e Gjykatës se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të rimarrë çështjen, pasi është i vetmi organ administrativ i ngritur për shqyrtimin e rasteve të pretendimeve për diskriminim.
- Nuk është domosdoshmëri shterimi i rrugës administrative, siç argumenton Gjykata, pasi vetë LMD-ja, lë të hapur mundësinë apo zgjedhjen e ankuesit se ku mund ta



paraqesë padinë e tij lidhur me pretendimin për diskriminim. Gjykata ka kompetencë vetë të shqyrtojë të gjitha paditë me objekt pretendimin për diskriminim. Vetë LMD-ja përcakton se, gjykata çmon vetë, sipas diskrecionit të saj nëse mund t'i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim pra, në asnjë moment nuk përjashtohet nga mundësia e shqyrtimit prej saj të këtij pretendimi. aq më tepër kur vetë paditësi e kërkon një fakt të tillë.

- Gjykata ka cënuar parimin e “arsyetimit të vendimit gjyqësor”, pasi kjo Gjykatë nuk ka arsyetuar në lidhje me shkaqet dhe objektin e kërtimeve të parashtruara në padi. Gjykata ka vendosur të shfuqizojë vendimin nr. 132, datë 15.09.2016 të KMD-së. Në referim të parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, pavlefshmëria relative parashikohet nga neni 118 i Kodit. Theksojmë se ky vendim është plotësisht i ligjshëm, pasi ai është marrë në përputhje të plotë me parashikimet e LMD, ashtu siç edhe është pasqyruar më sipër. Nuk ka asnjë element që cënon ligjshmërinë duke shkaktuar pavlefshmërinë relative. Në këtë logjikë, vendimi nr. 132 datë 15.09.2016, nuk është në kundërshtim me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit (LMD-së) dhe nuk është nxjerrë nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit, kanosjes apo dhunës fizike, elementë këto që do të shkaktonin pavlefshmërinë relative të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar ka vendosur pranimin e ankimit.

## GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Altina Nasufi dhe shqyrtoi çështjen mbi shkaqet e ngritura në ankim,

### V Ë R E N

#### I.Rrethanat e çështjes:

1. Paditësja [REDAKTUAR] rezulton se ka qenë në marrëdhënie pune si mësuese, në shkollën 9 vjeçare “Ali Demi”, Tiranë, nga data 17.09.2014, deri më datë 10.09.2015. Rezulton se, paditësja është larguar nga puna si mësuese në vitin 2015, shkak për të cilin i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padi për pagimin e dëmshpërblimeve që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës. Gjithashtu, rezulton se, paditësja me datë

05.10.2015, i është drejtuar me ankesë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me arsyetimin se largimi nga puna, ka qenë tërësisht diskriminues. Pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Vendimin Nr. 132 datë 15.09.2016, në përfundim të procedurave që ka zhvilluar, ka vendosur: “1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “për shkak tjetër” të znj. ██████████, nga ana e Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë. 2. Kundër këtij vendimi, lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.” Nga aktet shkresore, rezulton se, me datë 13.01.2016, paditësja është thirrur nga Komisioneri, ku është mbajtur një seancë dëgjimore. Në këtë seancë dëgjimore, rezulton se paditësja, ka paraqitur prova dhe fakte, në lidhje me diskriminimin për largimin nga puna. Me datë 15.09.2016, rezulton se paditësja është vënë në dijeni të vendimit Nr. 132, datë 15.09.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

1.1 Me padinë në gjykim paditësja ka parashtruar që ka qenë në marrëdhënie pune si mësuese në shkollën 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë nga data 17.09.2014, deri më 10.09.2015, e cila i ka zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme, si dhe duke përdorur format dhe mënyrat e diskriminimit, bazuar kjo në pikën 5, të Nenit 3, të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Pas largimit nga puna me datë 05.10.2015, i është drejtuar me ankesë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me largimin e saj nga puna. Me datë 15.09.2016, paditësja është vënë në dijeni të vendimit nr. 132, datë 15.09.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Paditësja pretendon se ky vendim, është marrë në shkelje flagrante të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e pikërisht të pikës 10, të nenit 33. Në këto kushte paditësja ka parashtruar se veprimet e të paditurit rezultojnë arbitrare, të kryera në kundërshtim flagrant me ligjin e si të tilla ato duhet të shfuqizohen.

3. Pala e paditur ka prapësuar se pretendimi i ankueses se është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se kandidatja tjetër për shkak të gjendjes arsimore, nuk është i argumentuar dhe nuk qëndron, pasi të dyja kandidatet e përmbushin këtë kriter. Në lidhje me këtë shkak të pretenduar diskriminimi, rezultoi se, ankuesja, ka bërë kallëzim penal ndaj drejtoreshës së shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë, për kanosje serioze për jetën. Për këtë kallëzim, Prokuroria ka vendosur mosfillim të procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ankuesja pretendoi gjithashtu se, është paragjykuar nga ana e kolegeve të saj për shkak të veshjes së saj të thjeshtë e modeste. Ky pretendim nuk rezultoi i provuar. Në përfundim të

gjithë procedurës së ndjekur, Komisioneri konstatoi se, ka paligjshmëri nga ana e Drejtorisë së shkollës, sa i takon procedurës së shpalljes së vendit vakant dhe vendimit të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, të cilët e kanë vendosur ankuesen në një pozicion të disfavorshëm. Vendimi nr. 132, datë 15.09.2016, është plotësisht i ligjshëm, pasi ai është marrë në përputhje të plotë me parashikimet e LMD, ashtu siç edhe është pasqyruar më sipër. Nuk ka asnjë element që çënon ligjshmërinë, duke shkaktuar pavlefshmërinë relative.

## **II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë:**

4. Gjykata ka pranuar pjesërisht padinë me këtë arsytim:

4.1 Nga aktet shkresore, rezulton se, me datë 13.01.2016, paditësja është thirrur nga Komisioneri, ku është mbajtur një seancë dëgjimore. Në këtë seancë dëgjimore, rezulton se paditësja, ka paraqitur prova dhe fakte, në lidhje me diskriminimin për largimin nga puna. Me datë 15.09.2016, rezulton se paditësja është vënë në dijeni të vendimit nr. 132, datë 15.09.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe i është drejtuar gjykatës me anë të kësaj padie objekt gjykimi. Gjykata vlerëson se Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese në fushën e punësimit. Që të ekzistojë një situatë diskriminimi duhet të ekzistojë një lidhje midis shkakut të pretenduar të diskriminimit dhe pasojave të disfavorshme që kanë ardhur për ankuesen. Neni 1, i LMD-se parashikon se “gjendja arsimore” është shkak i mbrojtur nga ky Ligj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton se të dy kandidatet si ankuesja ashtu edhe kandidatja tjetër znj. A.A., kishin arsim të lartë përkatës në lëndën e “histori-gjeografisë” dhe në përputhje me kërkesat e bëra në shpalljen e shkollës për vendin vakant të lëndës së histori-gjeografisë. Në këtë kuadër gjykata vlerëson se nga pala e paditur nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes në raport me pretendimin e ankueses se ajo është trajtuar në mënyrë me pak të favorshme se kandidatja tjetër për shkak të gjendjes arsimore. Ankuesja ka pretenduar se shkak për diskriminimin e saj nga drejtoresha e shkollës është bërë edhe denoncimi që i ka bërë asaj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë. Në lidhje me këtë shkak, të pretenduar diskriminimi, neni 1 i LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, ç’ka është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në

lidhje me këtë shkak të pretenduar diskriminimi, provohet se ankuesja, ka bërë kallëzim penal ndaj drejtoreshës së shkollës 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë, për kanosje serioze për jetën. Për këtë kallëzim, Prokuroria ka vendosur mosfillim të procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Nga konsultimi me dokumentacionin, Komisioneri ka konstatuar se kallëzimi penal i ankueses mban datën 05.10.2015, pra, mbas mbylljes së procedurave të shpallura për vendin vakant të lëndës së histori-gjeografisë, dhe pas vendimit të drejtoreshës së shkollës, me datë 10.09.2015 për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen. Pra, i gjithë konflikti i gjeneruar (mes ankueses dhe drejtueses së shkollës), ka ardhur pas komunikimit të bërë ankueses për përfundimin e marrëdhënies së punës me shkollën 9-vjeçare “Ali Demi”. Në kuadër të pretendimeve të palës paditëse të paraqitura me anë të kësaj padie, gjykata konstaton se pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes administrative duke zbatuar dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative sipas parashikimeve të nenit 80 e vijues të ligjit. Gjykata çmon se pala e paditur gjatë procedurës hetimore të ankesës së parashtruar duhet të kishte zbatuar parashikimet e nenit 80 të këtij ligji. Në këtë kuadër, pala e paditur duhet të kishte marrë në pyetje të gjithë subjektet e përfshira në situatën e pretenduar si diskriminuese e të mos ishte mjaftuar me administrimin e provave shkresore të depozituara dhe më pas të kishte proceduar sipas parashikimeve të nenit 81 të Kodit të Procedurave Administrative duke bërë vlerësimin e provave të administruara dhe arritur në përfundimin nëse ka qenë ose jo përpara një situatë diskriminimi në rastin konkret. Rezulton se ankuesja ka pretenduar gjithashtu se ajo është paragjykuar nga ana e kolegëve të saj (dy nga të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit të vlerësimit të saj në procedurën e konkurimit për vendin e shpallur vakant) për shkak të veshjes së saj të thjeshtë e modeste. Ky pretendim nuk rezulton të jetë verifikuar duke u thirrur dhe administruar dëshmitë përkatëse të këtyre shtetasve gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga ana e palës së paditur. Për shkak të analizës së mësipërme të tërësisë së provave të administruara në gjykim, duke arritur në përfundimin se i vetmi organ kompetent i ngarkuar nga ligji për kryerjen e një procedure të plotë hetimore në lidhje me diskriminimin është Komisioneri përkatës, gjykata vlerëson se duhet të procedojë me pranimin e pjeshëm të padisë për sa i përket kërimit për shfuqizimin e aktit administrativ Vendimit Nr. 132, datë 15.09.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe duhet të procedojë me detyrimin e palës së paditur, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të rimarrë në shqyrtim kërkesën ankimore të paditëses [REDAKTUAR] dhe të kryejë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes objekt procedimi administrativ.

4.2 Në lidhje me kërkimin për njohjen nga gjykata të diskriminimit gjykata çmon se kjo pjesë e kërkitës është e pabazuar në ligj për sa kohë që si palë e paditur në gjykimin për njohjen e diskriminimit duhet të kishte thirrur Shkollën 9-vjeçare “Ali Demi” Tiranë që pretendohet se është institucioni që ka kryer sjelljen me natyrë diskriminuese ndaj paditëses duke u kërkuar dhe dëmshpërblimi përkatës sipas ligjit, dhe përmes padisë së paraqitur po kundërshtohet në thelb vetëm vendimarrja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që nuk ka legjitimitet pasiv për këtë pjesë të kërkitës sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Në këtë kuadër duke vlerësuar se prej palës së paditur të thirrur në gjykim Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk është realizuar një hetim i plotë në përputhje me parashikimet e neneve 80 e vijues të ligjit 44/2015, gjykata vlerëson se duhet të procedojë me pranimin e pjesshëm të padisë për sa i përket shfuqizimin të aktit administrativ në trajtën e Vendimit Nr. 132, datë 15.09.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe duhet të rrëzojë padinë përsa i përket kërkitës tjetër të kërkesëpadisë.

### **III.Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:**

5. Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, sikurse ka vlerësuar drejt edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se ankimet janë paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012 *Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*, i ndryshuar, brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Proedurës Civile, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar aktivisht dhe pasivisht në padi, i legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 *(vendimet e paankimueshme)*.

6. Në analizë të shkaqeve të parashtruara përmes ankimeve, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi nr. 877, datë 07.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë objekt ankimi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor të zhvilluar në shkelje të rëndë të rregullave procedurale dhe për këtë shkak duhet prishur dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë administrative me tjetër trup gjykues për arsyet e poshtërenditura:

6.1 Gjykata Administrative e Shkallës së parë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes juridike në gjykim, analizën ligjore në cilësimin juridik të mosmarrëveshjes në gjykim, do të duhej ta

fokusonte mbi pretendimet e paditëses që lidhen trajtimin e saj diskriminues nga Drejtoria e Shkollës 9-Vjeçarë "Ali Demi" Tiranë, referuar parimeve të së drejtës dhe specifikisht përcaktimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" duke i dhënë një zgjidhje përfundimtarë pretendimeve të paditëses. Parimi i ndalimit të diskriminimit është parashikuar në nenin 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, me këtë përmbajtje: "Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në arsye të tilla si seksi, raca, ngjyra, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia ndaj një minoriteti kombëtar, pasuria, lindja ose çdo rrethanë tjetër"<sup>1</sup>.

6.2 Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit është sanksionuar edhe në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjina, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive".

6.3 Kjo normë kushtetuese sanksionon një detyrim, për çdo subjekt të së drejtës, përfshirë edhe autoritetet publike. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet jurisprudencës së saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke u shprehur se: "Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta", si dhe "vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtim i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë".<sup>2</sup> Ky

---

<sup>1</sup> Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 12 Gusht 1996, faqe 724.

<sup>2</sup> Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 12.09.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 02.11.2005;

qëndrim gjen shprehje dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është shprehur se nenin 14, e shoh të lidhur ngushtësisht me nene të tjera të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo parimin e diskriminimit e shoh në funksion të të drejtave të tjera të mbrojtura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Konkretisht, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka theksuar: “Neni 14 i Konventës plotëson të drejtat e tjera themelore të përcaktuara nga kjo konventë dhe protokollet e saj. Ky nen nuk qëndron i pa varur, duke qenë se ndikon në “gëzimin e të drejtave dhe lirive” të parashikuara në këto dispozita. Megjithatë aplikimi i nenit 14 nuk presupozon shkeljen e këtyre dispozitave – nuk ka vend për aplikimin e tij përveçse, në rastet kur faktet e çështjes lidhen me respektimin e të drejtave të tjera të Konventës”.<sup>3</sup>

6.4 Garancitë kushtetuese dhe konventore në lidhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit kanë gjetur parashikim të detajuar në ligjin nr. 10221/2010, ligj që ka për objekt të rregullojë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Qëllimi i ligjit është të sigurojë barazinë e personave përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë e për të marrë pjesë në jetën publike, si dhe *mbrojtje efektive* nga diskriminimi e nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Në lidhje me këtë situatë, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka përcaktuar disa standarde, me anë të të cilave ka synuar të vlerësojë nëse një ligj është diskriminues në termat e nenit 18 të Kushtetutës. Kjo përligjje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjete i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, shqyrton nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme.<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Çështja Palau Martínez kundër Francës, vendim datë 16.12.1997 i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

<sup>4</sup> Vendimi nr. 48, datë 15.11.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

6.5 Aktivizimi i juridiksionit gjyqësor në trajtimin përfundimtar të ankesave për diskriminim ka gjetur sanksionim në kreun VI të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 me titull “Procedurat para gjykatës”, sipas këtyre parashikimeve ligjore:

*Neni 34 “Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim”*

*1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.*

*2. Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale.*

*3. Një organizatë me interes të ligjshëm ose komisioneri mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që komisioneri ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi.*

*Neni 35 “Përgjegjësia individuale”*

*Çdo person mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij ligji, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka kryer një akt diskriminues në kuptimin e këtij ligji. Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e shtetit ose të personit juridik privat.*

*Neni 36 “Procedura para gjykatës”*

*1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje.*

*2. I dëmtuari nuk ka detyrim të njoftojë komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë.*

*3. Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim.*



4. Gjykata mund t'i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një vendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.

5. Paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese.

6. Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.

#### Neni 37 "Vendimi i gjykatës"

1. Vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit.

2. Vendimi i gjykatës u komunikohet të gjitha palëve të interesuara, përfshirë komisionerin.

3. Vendosja e masave, sipas këtij ligji, nuk përjashton vendosjen e masave sipas ligjeve të tjera.

#### Neni 38 "Dëmshpërblimi"

Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dukur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.

6.6 Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se në konfliktin e juridiksionit të plotë, sikurse është edhe rasti në gjykim, është gjykata që e zgjidh përfundimisht mosmarrëveshjen. Kontrolli gjyqësor i pushteteve administrative është rishikim i ushtrimit të pushteteve të tilla nga gjykatat administrative, të cilat janë ngarkuar nga ligji për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet personave, nga njëra anë, dhe shtetit, nga ana tjetër. Gjykatat administrative kanë juridiksion të zgjeruar dhe mund të hyjnë, si në çështjet e ligjit, ashtu edhe në ato të faktit. Gjykatat administrative gjykojnë mbi ligjshmërinë e një vendimi të një organi publik, duke i hyrë çështjes në fakt për një zgjidhje në themel të konfliktit. Për më tepër procedura në gjykimet administrative bazohet në një hetim të rreptë gjyqësor, siç quhet ndryshe parimi i hetimit

përfundimtar. Këto palë janë paditësi, i padituri, kundërpaditësi, kërkuesi në gjykimet gracioze, apo ndërhyrësi kryesor. Duke qenë se procesi gjyqësor civil apo administrativ zhvillohet në emër apo kundër tyre, në varësi nga pozita aktive apo pasive procedurale me të cilën janë legjitimuar proceduralisht në proces, gjykata me vendim përfundimtar mundet t'i ngarkojë ato me detyrime, mundet t'i akordojë atyre të drejta dhe mundet t'i ngarkojë ato me shpenzime gjyqësore (shiko nenin 109 të Kodit të Procedurës Civile). Për më tepër vetëm palët në kuptimin e ngushtë mundet të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes (shiko nenin 195 të Kodit të Procedurës Civile), të thërrasin palë të tjera në gjykim, të thërrasin persona të tretë në gjykim, të zgjidhin mosmarrëveshjen me pajtim apo të gëzojnë të drejtë apeli dhe rekursi të pakushtëzuar, si ndaj vendimeve të ndërmjetme, jopërfundimtare apo përfundimtare të gjykatës. Nga ana tjetër procesi gjyqësor civil apo administrativ njihet edhe bashkësinë apo kategorinë e ndërgjyqësve dytësor, e cila njihet si *ndërgjyqësia dytësore*, të cilët kanë një pozitë procedurale të ndryshme nga ndërgjyqësit kryesorë. Ato marrin pjesë në proces në kushte të caktuara (shiko nenin 191, 192 dhe 193 të Kodit të Procedurës Civile) dhe sipas skenarëve proceduralë të caktuara nga ligji, parashikime të cilat kanë për qëllim të mundësojnë aksesin në gjykatë edhe për personat që kanë interes mbi çështjen dhe mundësi reale dhe të drejtë për t'u dëgjuar para se të gjykohen. Ndryshe nga ndërgjyqësit në kuptimin e ngushtë, ndërgjyqësit dytësor lidhen indirekt nga produkti përfundimtar i procesit gjyqësor, nuk mundet të ngarkohen me detyrime nga vendimi përfundimtar dhe nuk mundet të ngarkohen me shpenzime gjyqësore. Ato gjithashtu nuk mundet të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes, nuk mundet të zgjidhin çështjen me pajtim, nuk mundet të thërrasin ndërgjyqës të tjerë në gjykim dhe kanë të drejtë të kushtëzuar apeli apo rekursi. Gjithashtu këto ndërgjyqës në kuptimin e gjërë nuk mundet të paraqesin kundërpadi apo të zgjerojnë objektin e mosmarrëveshjes. Nga ana tjetër, në nenin 162 të Kodit të Procedurës Civile vihen re dy kategori të tjera të ndryshme të llojeve të ndërgjyqësisë: *ndërgjyqësia e detyrueshme* dhe *ndërgjyqësia fakultative*. Në rastin e ndërgjyqësisë së detyrueshme palët, aktive apo pasive të procesit, janë së bashku në njërin apo tjetrën pozitë, jo si pasojë e disponimit maksimal të padisë apo parimit të disponibilitetit, por si pasojë e parashikimit të ligjit dhe natyrës juridike të mosmarrëveshjes apo marrëdhënies juridike civile/administrative që ato kanë me njëra-tjetrën. Në këto raste, nëse paditësi nuk ka thërritur të gjithë bashkëndërgjyqësit e nevojshëm apo të detyrueshëm, padia është me të meta, pasi ai ka detyrimin ligjor të thërrasë si të paditur këdo bashkëtitullar të së drejtës që ai pretendon të konfirmojë gjyqësisht (shiko për analogji saktësimin e bërë nga ligjvënësi nenin 161 të ndryshuar të Kodit të Procedurës Civile në vitin 2017). Në këto raste disponibiliteti

maksimal i padisë së paditësit kufizohet vetëm tek e drejta për të bërë të vlefshëm në emrin e tij procesin apo jo, apo thënë ndryshe e drejta për të ngritur padi apo jo. Në këto raste rrethi i ndërgjyqësve përcaktohet jo nga vullneti i palës apo nga vendimmarrja e gjykatës, por vetëm nga ligji dhe natyra juridike e marrëdhënies. Gjykata në këto raste ngarkohet nga ligji që të zbatojë ligjin procedural, në mënyrë që askush të mos lejohet që në emrin e tij të bëjë të vlefshme të drejtat e dikujt tjetër (shiko nenin 95 të Kodit të Procedurës Civile) dhe nga ana tjetër të mos lejohet që askush të gjykohet pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar (shiko nenin 33 dhe 42 të Kushtetutës.<sup>7</sup> Nga ana tjetër, të gjitha marrëdhëniet e tjera që formohen ndërmjet bashkëndërgjyqësve në procesin gjyqësor civil apo administrativ janë lloji i bashkëndërgjyqësisë fakultative, ku rrethi i personave si bashkëpaditës apo bashkë të paditur varet nga e drejta dhe fakulteti që ligji i njej paditësit për të vendosur se kujt ia kundrejton pretendimet në padi, apo thënë ndryshe është rrjedhojë dhe përditësim i parimit të disponibilitetit maksimal të padisë. Këtu gjykata ka rol pasiv dhe për thërritjen e palëve kryesore apo dytësore në proces iniciativën e kanë palët. Gjykata merr autoritet procedural vetëm në verifikimin e plotësisimit apo jo të kriterëve ligjore të krijimit dhe shtimit të ndërgjyqësisë dytësore fakultative. Nisur nga ky regjim juridik procedural konkludohet se ndërgjyqësia dytësore, apo thënë ndryshe personat e tretë, nuk mundet të jenë pjesë e ndërgjyqësisë së detyrueshme, pasi në këtë kategori palësh bëhet fjalë vetëm për palët në kuptimin e ngushtë, me të gjitha karakteristikat e treguara më lart. Ndërkohë mbetet që regjimi juridik i marrëdhënieve procedurale që krijohen ndërmjet palëve dhe personave të tretë dhe gjykatës nga ana tjetër të zgjidhen sipas regjimit juridik të ndërgjyqësisë fakultative....”<sup>8</sup>

7.2 Zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë ka vërtetuar se kërkimi i paditëses në objektin e padisë, ai i “Njohjes nga gjykata të diskriminimit për largimin nga puna”, i kundërdrejtohet organit publik: Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Ali Demi” Tiranë, organ i cili nuk është thirrur në gjykim, pasi kjo është *ndërgjyqësi e detyrueshme*, në kuptim të parashikimeve të neneve 34-38 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. Gjykata e

<sup>7</sup> Shiko për më tepër edhe nenin 161 të ndryshuar të Kodit të Procedurës Civile, që hyn në fuqi në datë 05.11.2017.

<sup>8</sup> Të njëjtin qëndrim Kolegji Administrativ ka mbajtur edhe në vendimin nr. Nr. 00-2018-550 (76) date 03.04.2018

shkallës së parë ka patur për detyrë që gjatë gjykimit të orientonte krijimin e saktë të ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme.

8. Për sa u arsyetua më lart, Gjykata Administrative e Apelit konkludon se në zbatim të nenit 50, germa “ç” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendimi i Gjykatës së Administrative të Shkallës së Parë për shkelje të rënda procedurale, duhet prishur dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me tjetër trup gjykues.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja “ç” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

### **V E N D O S I :**

- Prishjen e vendimit nr. 887, datë 07.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

**Tiranë, më 24.02.2020**

**GJYQTARE**

**Fjoralba PRIFTI**

**D.V**

**GJYQTAR**

**Arjan QAFA**

**D.V**

**GJYQTARE**

**Altina NASUFI**

**D.V**

**Vërtetohet njësia me origjinalin**

Kancelari  
Leonard Shtani  
Bran